

Mbi identitetin islamik të Lidhjes së Prizrenit (Prizren Ittifaki)

Olsi Jazexhi

Firenze,
më 01 qershor 2007

Çfarë flitet për Lidhjen e Prizrenit?

Në vitin 1999 ndërsa lexoja librin e Jakob Landaut: *‘Politika e Pan-Islamit: ideologjia dhe organizimi’* më bëri përshtypje fakti që Lidhjen e Prizren të cilën nëpër shkollat tona fëmijë e mësojnë si një Lidhje sa anti-turke aq edhe kombëtare, historiani britanik e klasifikonte si një organizatë të nxitur nga vetë sulltan Abdulhamidi II, për të mobilizuar muslimanët e Ballkanit që të mbrohen nga pushtimi i fuqive të krishtera. Landau mendonte se Lidhja e Prizrenit u sponsorizua indirekt nga sulltani, dhe për këtë në kapitullin e “Shoqërive dhe Vëllazërive” të ndërtuara nga sulltani në suazat e pan-islamizmit, thotë se:

Një organizatë (pan-islamike) edhe më me jetëgjatë ishte Lidhja Shqiptare e Prizrenit, në disa raste e njohur si Lidhja Shqiptare. Ajo u ndërtua pas takimit të fisnikëve vendas më 10 qershor 1878, fillimisht për të kërkuar autonomi për Shqipërinë. Megjithatë qëllimi parësor i themeluesve të saj ishte të ndalonte copëtimin e Shqipërisë në Kongresin e Berlinit, kështu që dy dokumentat bazë themelues të Lidhjes, dëshmonin besnikërinë ndaj Perandorisë dhe sulltanit, duke ju referuar edhe sheriatit. Në vitin 1878 ndërmjet Prizrenit dhe qeverisë në Stamboll kishte komunikime intensive. Theksi ndaj identitetit musliman dhe osman ishte natyral për një nga grupet më muslimane të perandorisë, i cili kërkonte siguri në një kohë krize si kjo nga bashkëbesimtarët e tjerë.¹

Mbi karakterin islamik të Lidhjes së Prizrenit shkruan edhe Noel Malkolmi, i cili në librin “Kosovo a short history” kujton citimet e një zyrtari britanik në Kosovë më 1878 i cili thoshte se: *Lëvizja ëshë më shumë një lëvizje fetare sesa shekullare, dhe*

¹ Jacob Landau (1990), *Politics of Pan-Islam*, Oxford University Press, fq. 48 – 49

udhëhiqet nga myftilerët, ulematë dhe kadijtë.... Jam i mendimit se tashmë është mëse e qartë se Porta e Lartë dhe Lidhja janë në një mendje, dhe po punojnë për të arritur një qëllim të përbashkët – mbrojtjen e provincës.²

Këto dy paragrafë më kanë bërë që përpara shumë vitesh të kërkoja dhe kuptoj përse në librat tanë të historisë, Lidhja e Prizrenit, ashtu si shumë pjesë të tjera të historisë sonë është trajtuar sipas mendësisë së shkollës sllavo – greke në Ballkan e cila presupozon që popujt e Ballkanit vuajtën nën tiraninë turke, dhe për më tepër shqiptarëve, historianët tanë nacional-komunistë ju kanë fshirë rëndësinë që islami ka patur në historinë e ngjizjes së tyre kombëtare. Lidhjes së Prizrenit apo siç emri i saj original është *Prizren Ittifaki*,³ i është ndryshuar edhe emri dhe njihet si ‘Lidhja Shqiptare e Prizrenit’. Në librin ‘Historia e Popullit Shqiptar’, volumi II, botuar nga Akademia e Shkencave në Tiranë më 2002 në Kreun V të titulluar ‘Lidhja Shqiptare e Prizrenit’ me autor Kristo Frashërin, Lidhja portretizohet si një organizatë laike dhe islamofobike. Edhe pse autori pranon që në këtë lidhje kishte një rrymë që kërkonte të bënte ‘një lidhje islamike, ku të merrnin pjesë të gjitha popullsitë myslimane të Gadishullit Ballkanik, pavarësisht nga kombësia e tyre, nga e cila, logjikisht, do të përjashtoheshin shqiptarët e krishterë, si ortodoksë, edhe katolikë.’ dhe ‘Veç kësaj, sulltanistët... nuk e pranonin as në parim idenë e një vilajeti shqiptar, sepse ky vilajet, sipas tyre, do t’i ndante shqiptarët myslimanë nga “vëllezërit” myslimanë të Gadishullit Ballkanik dhe të Perandorisë Osmane⁴’ fjala logjikisht që kam nënvizuar më lartë apo edhe vënia nga autori në thonjëza i fjalës “vëllezër myslimanë” tregon presupozimin e tij i cili mendon se nëse Lidhja e Prizrenit do të ishte islamike, atëherë automatikisht do të kishim diçka kundër të krishterëve dhe sipas historisë nacional-komuniste në Shqipëri, të jesh Islamik përbën krim.

Për gardën e historishkruesëve të Akademisë së Shkencave në Tiranë, shqiptari i imagjinuar i modernitetit është politikisht korrekt vetëm kur portretizohet si laik dhe ateist.⁵ Në këtë vazhdë mendimi, Kristo Frashëri këmbëngul në kapitullin e tij për Lidhjen e Prizrenit, se ajo herë pas here infiltruhej nga feudalët turq të cilët donin të gënjejnë shqiptarët me islamin. Megjithatë shqiptarët vigjilentë të Frashërit nuk binin në grackën e feudalizmit islamik: *Këto qëndrime u kundërshtuan nga atdhetarët shqiptarë... që nuk mund të pajtoheshin me platformën e qarqeve sulltaniste dhe në mënyrë të veçantë me idenë konservatore të një lidhjeje islamike, e cila po të krijohet do ta shuante emrin e Shqipërisë.⁶*

Për të trembur shqiptarët me identitetin tonë kulturor islam dhe krijuar në mendjen e lexuesit frikë ndaj mundësisë së qenies së Lidhjes së Prizrenit një organizatë islamike, Kristo Frashëri shkruan: *Funksionarët e administratës dhe përkrahësit e tyre sulltanistë ushtruan në këto mbledhje presion të fuqishëm për t’i detyruar pjesëmarrësit që t’i nënshkruanin protestat e tyre jo si banorë shqiptarë, por si nënshtetas islamikë të lidhur me Perandorinë Osmane.⁷* Por sipas Frashërit, shqiptarët dinin gjithnjë të

² Noel Malcolm, *Kosovo a short history*, Harper Collins, 1999, fq. 222

³ Emra të tjerë të lidhjes kanë qenë edhe *Prizren Ittihadiyyesi*, apo thjeshtë *Itihad*

⁴ *Historia e Popullit Shqiptar (2002), Vol II, Rilindja Kombëtare vitet 30 te shek. XIX – 1912*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Toena, Tiranë, fq. 151

⁵ apo siç myslimanët do ta vinin *pa din e pa imam* apo *qafir*

⁶ *Historia e Popullit Shqiptar (2002)*, fq. 151

⁷ *Ibid*, fq. 153

triumfojnë ndaj feudalëve prapanikë osman që deshën t'i bëjnë islamikë. Ata kundërshtuan rrufjanët turq: *Në asnjë nga krahinat shqiptare, pjesëmarrësit e mbledhjeve nuk pranuan ta cilësonin veten e tyre si banorë islamikë. Në të gjitha aktet drejtuar Fuqive të Mëdha banorët myslimanë dhe të krishterë, protestonin si shqiptarë, si pjesëtarë të një kombi të vetëm. Madje, në shumë raste, pjesëmarrësit e mbledhjeve popullore hartuan peticione drejtuar Portës së Lartë, me anën e të cilave kërkonin reforma autonomiste për Shqipërinë.*⁸

Megjithatë faktet historike të cilat rrëfohen më në detaj më poshtë dëshmojnë të kundërtën. Pikë së pari pretendimi nga Kristo Frashëri se '*Në të gjitha aktet drejtuar Fuqive të Mëdha banorët myslimanë dhe të krishterë, protestonin si shqiptarë*' nuk është i vërtetë.⁹ Pse siç Xhafer Belegu kujton, katolikët filoautriakë të veriut të Shqipërisë u deklaruan kundër Lidhjes së Prizrenit, kur ajo sulmoi agresorët austriakë në Bosnje. Në shumicën e akteve *Lidhja* i është drejtuar Fuqive të Mëdha si një Lidhje Myslymanësh të cilët kërkonin të rojnë nën pushtetin e sulltanit. Për më tepër Evangelos Kofos tregon se Lidhja e Prizrenit është kundërshtuar edhe nga të krishterët ortodoksë të Jugut të Shqipërisë, të cilët nuk pranonin as që të nënshkruanin Peticione kundër Shën Stefanit pasi deshën të bashkohen me Greqinë: *në ditët e Kongresit të Berlinit, Maratos tregon se të gjithë të krishterët (ortodoksë) të sanxhakut të Gjirokastrës – duke përfshirë ata të qyteteve të Gjirokastrës, Delvinës, Tepelenës dhe Përmetit – refuzuan të nënshkruajnë peticione (kundër Shën Stefanit). Të njëjtin qëndrim kishin mbajtur edhe të krishterët e Sarandës, siç raportonte konsulli grek në këtë qytet.*¹⁰ Të njëjtën gjë e dëshmon edhe Th. P. Delyani nga ministria e jashtme greke në shkurt të vitit 1879 kur përmend që të krishterët nuk pranonin të bashkëpunojnë me Lidhjen.¹¹

Megjithatë, Kristo Frashëri vazhdon e thotë që: *Delegatët që morën pjesë në Kuvendin e Përgjithshëm ...kërkuan me këmbëngulje që Kuvendi, ashtu siç ishte parashikuar prej tyre, të formonte një Lidhje Shqiptare me karakter kombëtar. Ndryshe nga këta, delegatët, që i takonin krahut sulltanist, u përpoqën që organizata që do të themelohej të kishte një karakter islamik e jo kombëtar shqiptar dhe t'ia nënshtronin atë interesave të Stambollit.*¹² Dhe për të konkluduar teorinë e tij konspirative me islamikë dhe me sulltanë thotë që: *Vendimi i Kuvendit të Prizrenit për themelimin e Lidhjes ishte një fitore e madhe e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, pasi me anën e tij iu dha goditja e parë dhe e fuqishme përpjekjeve të Stambollit për ta veshur Lidhjen me karakter islamik dhe u hodhën themelet e një organizate kombëtare shqiptare, e cila, qysh në ditën e parë të saj, pati një karakter atdhetar.*¹³

Ndërsa Kristo Frashëri e imagjionon Lidhjen e Prizrenit si një organizatë anti-islamike dhe laiko-kombëtare, Jakob Landau, Peter Barlt, Kirby Green¹⁴ dhe një numër i

⁸ Ibid

⁹ Shiko më poshtë deklaratat e Shkupit, Prizrenit, Dibrës etj

¹⁰ Evangelos Kofos, *Greek reaction to the Albanian League of Prizren*, Balkan Studies, Vol 23, 1982, fq. 356

¹¹ Letër e M. Delyanit datë 9/21 shkurt 1879, The British Museum, London, *Accounts and Papers* (36). 1878-9, LXXVII, 77,336 – 337

¹² *Historia e Popullit Shqiptar* (2002), fq. 155

¹³ Ibid, fq. 156

¹⁴ Nëse dikush do të kuptoj 'Mitin e Lidhjes' dhe historinë e saj të vërtetë, *Letra e konsulli britanik në Shkodër Kirby Green drejtuar Kontit Granville* në The British Museum, London, *Accounts and Papers* (43). 1880, LXXXII, 82, 511 – 512 është shkrimi më i mirë që duhet të konsultohet.

madh historianësh botërorë e shohin si një organizatë islamike, të ndërtuar nga muslimanët e Gegënisë dhe Bosnjes me mbështetjen e sulltan Abdulhamitit II, për të mbrojtur muslimanët Ballkanas pas Kongresit të Berlinit. Përpyekjet në librat e historisë në Shqipëri që manipulojnë historinë, duke shpikur konceptin e kombit laik në çdo ndodhi historike, sipas Noel Malkolmit janë një rrëfim i varfër i historisë. Një histori e vërtetë nuk mund të shkruhet duke supozuar që shqiptarët – përveç ndonjë ‘agjenti’ islamik të sulltanit – luftonin për të çliruar atdheun nga sundimi osman.¹⁵ Nga që historia është më e komplikuar sesa versioni i thjeshtë që nacional-komunizmi ndërtoi në Shqipëri, më poshtë po sjell një përshkrim ndryshe të krijimit të Lidhjes, njerëzve që e drejtuan dhe motivimet e tyre, duke u bazuar mbi faktet e disa historianësh si Xhafer Belegu, Eqrem Bej Vlora, Peter Bartl etj dhe disa dokumentash arshivorë të konsujve britanikë.

Pse u krijua Lidhja e Prizrenit?

Në vitin 1878 kur në fund të luftës Ruso – Turke (1877 – 1878), Perandoria Osmane u mund, dhe u detyrua t’i dorëzojë Rusisë dhe aleatëve të saj pjesë të mëdha tokësore, në Rumeli sulltan i ri në pushtet Abdylhamiti II, ashtu si edhe muslimanët Ballkanas u shqetësuan pamasë për tragjedinë që solli lufta. Në Traktatin e Shën Stefanit (Yeshil Koy-t) dhe më pas në Kongresin e Berlinit të nënshkruar në 13 korrik 1878 perandoria u detyrua të dorëzojë më shumë se dy të pestat e territorit të saj në Ballkan, ku ndër të tjera përfshiheshin territore të populluara nga muslimanë boshnjakë dhe shqiptarë. Duke qënë se shqiptarët ishin të fesë islame dhe ishin element shtetformues i perandorisë dhe në raste lufte, luftonin me osmanët kundër të krishterëve, Kongresi i Berlinit nuk mori parasysh kërkesat e tyre.¹⁶

Ndërsa austriakët nisën pushtimin e Bosnjes në 29 korrik 1878, Mali i Zi që ishte shpërblyer nga Kongresi i Berlinit me marrjen e Kazasë së Gucisë (ku hynte edhe Plava) u bë gati të nisë pushtimin gjithashtu.

Të shqetësuar nga mundësia e pushtimit të trojeve të tyre, shqiptarët ashtu si edhe muslimanët e tjerë të Ballkanit nisën të marrin masa mbrojtëse. Për t’ju përgjigjur pushtimit nga të krishterët konsulli i Greqisë në Shkodër, Mavromati, raportonte i shqetësuar në 18 shkurt 1878 eprorëve të tij se në mesin e muslimanëve ishte formuar një Komitet në Prizren të cilin shtypi i Evropës e konsideronte si një ‘Lidhje të Rrezikshme Shqiptare’. Në të njëjtin raport konsulli tregonte që në Shkodër autoritetet osmane, nxisnin njerëzit që t’i rezistojnë pushtimit dhe kishin vendosur nje telegram:

*në të cilin kishte gënjeshtër mbi përparimin e kryengritjes në Bosnje, dhe prapësimin e austriakëve ku thuhej se luftëtarët kishin prerë 49.000 humdë austriakësh.*¹⁷

¹⁵ Noel Malcolm, fq. 217

¹⁶ Peter Bartl (2006), *Muslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912)*, Tiranë, fq. 142.

¹⁷ Skender Rizaj (1978) (trans.) *Lidhja e Shqiptare e Prizrenit ne Dokumentet Angleze (1878 – 1881)*, Prishtina, fq. 48

Ndaj mundësisë së pushtimit të tokave të banuara nga muslimanët ballkanas reaguan një seri qytetesh të Rumelisë. Kështu në mars 1878 paria muslimane e Shkupit që ishte shqetësuar nga vendimet e Traktatit të Shën Stefanit i tregonte me një petition fuqive të mëdha që ishin të lumtur që rronin nën regjimin atëror dhe të drejtë të sulltanit dhe për këtë arsye kundërshtonin vendimet e Traktatit.¹⁸

Ndërsa në 3 maj 1878 konsulli britanik në Shkodër, Kirby Green vinte në pah që në mesin e muslimanëve të Shqipërisë Veriore po depëronte *Lidhja*, një organizatë e cila po mobilizonte muslimanët dhe kërcënonte të masakrojë meshkujt e krishterë të cilët besonin se ishin bullgarë. Konsulli vë në pah që të krishterët vendas ishin të trembur nga gjendja e tensionuar e muslimanëve.¹⁹

Ndërsa në 16 maj 1878 banorët e Dibrës i dërguan ambasadorit britanik në Stamboll Layardit, një notë proteste ku kërkonin mos bashkimin me Bullgarinë, por dëshirën për të jetuar nën Qeverinë Osmane.²⁰ Ndërsa në 12 maj 1878 banorët e Prizrenit i dërguan telegrame ambasadave të Anglisë, Francës, Italisë dhe Austro-Hungarisë në Stamboll ku deklarorin që:

shumica e banorëve të vilajetit tonë janë muslimanë; të krishterët te ne përfaqësojnë pakicën e ata janë katolikë dhe ortodoksë... të krishterët flasin mes vedi një përzjerje të gjuhës serbe, malazeze dhe bullgare, por gjuha e përgjithshme që përdoret nga muslimanët dhe të krishterët është turqishtja dhe shqipja... ne nuk i nënshtrohemi administratës serbe dhe bullgare. Ne nuk njohim asnjë qeveri përveç asaj osmane... dhe jemi të gatshëm për çdo flijim, qoftë edhe të vdesim, për të mbrojtur të drejtën tonë të pacënueshme.²¹

Telegramet dhe petitionet e mësipërme që tregojnë shqetësimin e muslimanëve Ballkanas në nivelin lokal po ndiqeshin nga mobilizimi i parisë muslimane të Ballkanit. Siç Mavromati vë në dukje që në muajin shkurt të vitit 1878 një organizatë e njohur si *Itifaki* apo *Lidhja* po çonte korrierët e saj nga qyteti në qytet. Spiunazhet evropjane në Rumeli që po nuhasnin tensionimin e muslimanëve dhe lëvizjen e tyre, e konsideronin lëvizjen si një 'Lidhje të Rrezikshme Shqiptare'. Mobilizimi i parisë së muslimanëve të Ballkanit do të arrinte kulmin në fund të majit dhe fillimin e qershorit 1878 kur në Gjakovë pashallarët, bejlerët dhe hoxhallarët e Kosovës dhe Bosnjes u takuan dhe vendosën datën 10 qershor 1878 si ditën kur krerët e muslimanëve do të tuboheshin në Prizren dhe vendosin për qëndrimin e tyre ndaj kërcënimit të krishterë.

Xhaferr Belegu në librin '*Lidhja e Prizrenit e veprimet e sajë*' kujton që përpara se ky takim të zhvillohej, në rjedhën e ngjarjeve kishte hyrë vetë sulltan Abdylhamiti II. Ai kishte thirrur në Stamboll Sheh Mustafa Tetovën dhe Abdyl Be Frashërin për t'i udhëzuar për zhvillimin e lëvizjes. Ndërsa në aparcë sulltan Hamiti tregojnë sikur donte të përmbushte kërkesat e fuqive të mëdha, nën rogoz nxiste muslimanët që të mobilizohen dhe përballojnë agresionin. Belegu thotë që sulltani i shkroi gjithashtu edhe kadiut të Gjakovës Ahmet Efendi Koronicës, myderizit të Prizrenit Ymer Efendiut dhe

¹⁸ (Citimet e dokumentave britanike janë nga botimi i tyre nga Skender Rizaj) The British Museum, London, *Accounts and Papers* (38). 1878, 83, 933

¹⁹ Public Record Office, London, *F.O.195/1186*

²⁰ Public Record Office, London, *F.O.195/1206*

²¹ The British Museum, London, *Accounts and Papers* (38). 1878, LXXXIII, 83, 931, 932

myftiut të Dibrës Jonuz Efendiut, ndërsa ju dha urdhër komandantëve ushtarakë në Shqipëri që të mos e pengonin zhvillimin e Lidhjes.²² Këtë fakt e përmend edhe Eqrem Bej Vlora i cili thotë që qeveria qëndrore në Stamboll jo vetëm që u tregua dashamirë ndaj idesë, por mori pjesë aktive në themelimin e Lidhjes në Prizren: pasi ishte në interesin e saj të nxiste një lëvizje kundër kërkesave sllave e pak më vonë edhe kundër atyre greke ... që të tërhiqte vëmendjen e Evropës.²³

Në takimin e Prizrenit përveç krerëve muslimanë të Kosovës shkuan delegatë edhe nga Shkodra, ku paria zgjodhi Jusuf Agë Sokolin, Selim Beun dhe Mulla Junus efendiun si përfaqësues. Siç Noel Malkolm citon emisarin britanik që thoshte që:

*Lëvizja ëshë më shumë një lëvizje fetare sesa shekullare, dhe udhëhiqet nga myftilerët, ulematë dhe kadijtë.... Jam i mendimit se tashmë është mëse e qartë se Porta e Lartë dhe Lidhja janë në një mendje, dhe po punojnë për të arritur një qëllim të përbashkët – mbrojtjen e provincës.*²⁴

Bie në sy me të drejtë që anëtarët që morrën pjesë në Lidhje ishin të gjithë muslimanë. Kjo kuptohet edhe në rastin e delegatëve shkodranë ku asnjë emër katoliku nuk lexohet.

Lidhja zhvilloi takimet e saj në datën 10 qershor 1878 në Xhaminë e Bajraklisë dhe në medresenë e Mehmet Pashës në Prizren. Në Lidhje (Ittifak) erdhën edhe delegatë nga Selaniku, Jenipazari dhe Sjenica.²⁵ Në Prizren por edhe mbarë Kosovën, krijimi dhe organizimi i Lidhjes u njoh me emrin e saj osman, *Prizren Ittifaki* apo *Prizren Ittihadi*.

Pas disa ditë bisedimesh më në fund në 18 qershor 1878 Lidhja botoi vendimet e saj (Karar-Name) të cilat ishin si vijon:

1. Lidhja jonë është forumar me qëllim që të mos njohë asnjë qeveri tjetër përveç Perandorisë Osmane dhe të mbrojë integritetin tokësor me të gjithë mjetet
2. Qëllimi ynë i lart është të mbrojmë të drejtën e lartmadhërisë së tij sulltanit, sovranit tonë. Në do quajmë armiq të kombit (osman) dhe atdheut të gjithë ata që kundërshtojnë dhe prishin qetësinë, ata që dobësojnë qeverinë dhe bashkëpunëtorët e tyre. Në rast se turbulluesit nuk heqin dorë do i dëbojmë jashtë shtetit
3. Ata delegatë të krahinave të tjera që duan të hynë në Lidhjen tonë do i pranojmë me gëzim dhe regjistrojmë si miq të qeverisë dhe vendit
4. Në bazë të Sheriatit do të mbrojmë jetën, pasurinë dhe nderin edhe të atyre që nuk janë muhamedanë, por janë besnikë, tamam si për veten tonë. Ndërsa kryengritësit do ti dënojmë sipas fajit.
5. Të gjitha shpenzimet për luftëtarët që do të mbledhin krahinat do të rregullohen dhe perballohen në bazë të dispozitave që do japim. Ndihmat që do na vinë nga jashtë do ti pranojmë me kënaqësi.
6. Duke patur parasysh gjendjen e Ballkanit nuk do pranojmë në asnjë mënyrë fuqitë e huaja në tokat tona.

Ne nuk do të njohim në asnjë mënyrë Bullgarinë dhe as duam t'ia dëgjojmë emrin; edhe Serbia në rast se nuk na i dorëzon tokat me të mirë që na ka marrë, do të

²² Xhafer Belegu (1939), *Lidhja e Prizrenit e veprimet e saj, 1878 – 1881*, Tirane, fq. 17-18.

²³ Eqrem bej Vlora, *Kujtime – Vëllimi i parë 1885-1912*, Tiranë, 2001, fq. 159

²⁴ Noel Malcolm, *Kosovo a short history*, Harper Collins, 1999, fq. 222

²⁵ Xhaferr Belegu (1939), op. cit., pp. 15 – 20

dërgojmë kundër saj një fuqi dhe t'ia marrim me pushkë. Edhe kundër Malit të Zi do veprojmë në të njëjtën mënyrë.

7. Bashkatdhetarëve besnikë të qeverisë që kanë hyrë në Lidhjen tonë do ti japim dorën dhe ndihmojmë sipas mundësisë.
8. Në rast se një krahinë ka probleme për të zbatuar vendimet, krahinat fqinje do ti shkojnë në ndihmë
9. Kushdo që del nga Lidhja jonë, Zot na ruaj! Kushdo që spiunon, dhe vepron sipas qejfit dhe dëgjon urdhërat e të parëve do të marrë dënimin që meriton.
10. Asnjë vendas i kujt do krahine që do me dalë nga Lidhja, i çfarëdo feje qoftë nuk do lejohet të shkojë as në Serbi e as në Mal të Zi. Në rast se shkon do njihet si spiun dhe dënohet.
11. Kushdo që ka vënë në dispozicion të Lidhjes diçka dhe i shmanget detyrimit, s'dëgjon urdhërat, sillet brutalisht apo bën ndonjë ç'nderim do të dënohet sipas fajit.
12. Dërgimi i fuqive, thirrja dhe përdorimi i tyre do të bëhet sipas udhëzimeve të përpiluara.
13. Për të zbatuar këto nene do ti jepet rëndësi korespondencës.
14. Është rënë dakort që qeveria nuk do hyjë në punët e Lidhjes dhe as Lidhja në punët e saj; përndryshe ky do shihet si cënim i të drejtës.
15. Një kopje i këtij vendimi do i paraqitet çdo krahine dhe qyteti.
16. Në bazë të besës së lidhur nga burrat e patrembur të Shqipërisë së Veriut, Jugut dhe Bosnjes, të atyre që kur kanë lindur nuk kanë njohur tjetër zanat por pushkën dhe që për *Din*, *Devlet* dhe *Vatan* japin jetën, kanë zgjedhur Prizrenin si kryeqytet të Lidhjes.²⁶

Sikur e themeluan këtë Lidhje edhe në të ardhmen nuk do durojmë tiranë që të shtypin vendet tona. Bijtë tanë dhe bijtë e tyre do të jenë besnikë të Lidhjes dhe kush largohet nga ajo do të konsiderohet sikur dikush që braktis Islamit dhe do mallkohet dhe përbuzet nga ne. Ne obligohemi ti jemi besnik këtij vendimi me firmat tona (47 firma).²⁷

Siç lexohet në pikën 4 por edhe në fund të Karar Namesë, Lidhja ishte një organizatë që synonte të mobilizojë muslimanët ballkanas për vetëmbrojtje, implementojë Sheriatin në të gjithë territorin e saj dhe shtrihet nga Bosnja deri në Jug të Shqipërisë. Edhe pse ishte konceptuar si një Lidhje Pan-Islamike, ajo shquhet nga toleranca për të krishterët ku në pikën 4 Lidhja zotohet që të mbrojë edhe jomuhamedanët.

Pas disa ditësh, kur me Lidhjen u bashkuan edhe qyteteve të tjera, ku vendosen mbrojtjen e atdheut ushtarakisht, ajo përpiloi disa vendime të dyta që janë si vijon:

1. Asnjë krahinë nuk do të njohë ndonjë qeveri tjetër përveç asaj të Perandorisë Osmane.
2. Nëse Turqia nuk paraqitet dhe Kongresi i Berlinit nuk do të njohë të drejtat tona mbi vendet e pushtuara nga Serbia dhe Mali i Zi, atëherë ne do rrokim armët për ti ri-pushtuar.
3. Në qoftë se fuqitë tona do të mundin të çlirojnë vendet e pushtuara, atëherë do të zbatohen masat e duhura.

²⁶ kopjen origjinale në osmanisht të *Karar-Namesë* shihe në fund të shkrimit

²⁷ Ibid. fq. 30 – 33 teksti është përshtatur në toskërisht nga varianti i përkthyer nga Xhaferr Belegu

4. E gjithë fuqia jonë do të përbëhet prej pesë ushtrishë: atyre të Shkodrës, Shkupit, Kosovës, Jenipazarit dhe të Herzegovinës.
5. Ajo e Shkodrës do sulmojë Malin e Zi: oficerët dhe bajraktarët do të zgjidhen nga populli.
6. Në Guçi përveç vendësve do të dërgohen edhe 2000 nga Gjakova dhe Berana dhe 1000 nga Peja.
7. Jenipazari përveç fuqisë që do të mbajë për mbrojtjen e vendit do të dërgojë edhe 1000 në Kolashin.
8. Në Bjelopolje mjafton fuqia vëndase.
9. Në Prepolje, Kajnica, Tashlixhë dhe Foçë përveç fuqive të tyre, do të dërgohen edhe 2000 të tjerë.
10. Për të ruajtur vijën Gracko – Trebinjë, përveç fuqisë së Herzegovinës, do të ketë 10000 burra nga Sarajeva dhe këta sëbashku do të formojnë ushtrinë e Herzegovinës.
11. Fuqia e Shkupit, Kosovës dhe Jenipazarit do të sulmojë Serbinë sipas instruksioneve tona.
12. Në qoftë se armiku i kërcënohet njëres krahinë, komandanti i krahinës në rrezik do të lajmëroj komandantët e tjerë që të marrin dijeni të gjithë dhe sulmohet armiku.
13. Në rast se në luftën tonë kundër Malit të Zi, Serbia qëndron asnjëherë fuqitë që janë caktuar për atë, kalojnë kundër Malit të Zi.
14. Në qoftë se si Mali i Zi ashtu edhe Serbia do të luftojnë kundër nesh atëherë këto fuqi detyrohen të luftojnë burërisht dhe me ngulm sipas besës që kemi dhënë.

Këto dy vendime u nënshkruan nga përfaqësuesit e Prizrenit, Gjakovës, Pejës, Gucisë, Jenipazarit, Sjenicës, Tashlixhës, Mitrovicës, Vuçiternit, Prishtinës, Gjilanit, Shkupit, Tetovës, Kërçovës, Gostivarit, Dibrës së Madhe dhe Dibrës së Vogël.²⁸

Siç shihet nga vendimet e Lidhjes, kuptohet që synimi i organizatorëve të saj ishte mbrojtja e viseve të populluara nga muslimanët në Ballkan. Qofshin ata boshnjakë ose shqiptarë. Përndryshe nga ç' shkruan Kristo Frashëri, kur në Korrik të vitit 1878 trupat austriake nisën pushtimin e Bosnje dhe Herzegovinës, Lidhja, sipas pikës 12 të statusit të Luftës, i shkoi Bosnjes në ndihmë. Në fakt ishin delegatët e Bosnjës që kërkuan ndihmë ndaj përfaqësuesit të Lidhjes në Jenipazar: Ejup Beut, Muhamet Efendiut, Murat Beut, Ibrahim Efendiut dhe Estref Efendiut.

Ndihma që Lidhja i ofroi boshnjakëve për t'u mbrojtur nga agresioni austro – hungarez, bëri Austro – Hungarinë të sulmojë Lidhjen dhe cilësojë atë si një organizatë islamike, ndërsa në të njëjtën kohë i dha urdhër katolikëve të tërhiqen nga mbështetja e saj.²⁹ Nga Pashallarët shqiptarë që shkuan në mbrojtje të Bosnje dhe Herzegovinës ishin Ali Draga nga Mitrovica me 5000 – 7000 vetë dhe Ejup Beu nga Jenipazari me ushtarët e tij. Xhaferr Belegu tregon që shqiptarët që luftuan në mbrojtje të Sarajevës mbajtën rroba civile në mënyrë që të mos shiheshin si ushtarë osmanë. Megjithatë rezistenca shqiptaro – boshnjake do të thyhej në 19 Gusht 1878 kur pas një luftimi shtëpi më shtëpi austriakët do të pushtonin Sarajevon. Trupat e muslimanëve me këtë luftë numëronin rreth 93.000 vetë, ndërsa austro – hungarezët kishin rreth 268.000 vetë. Në luftime austro-hungarezët

²⁸ Ibid. fq. 33 – 34

²⁹ Ibid, fq. 42 – 43

lanë të vrarë rreth 6.000 ushtarë dhe oficerë ndërsa boshnjakët dhe shqiptarët shumë më tepër. Pas pushtimit, austro – hungarezët vendosën regjim ushtarak në vend që zgjati për disa vite.³⁰ Ndërsa Xhafer Belegu mendon që pas thyerjes së udhëheqësit boshnjak Haxhi Lojës nga trupat e gjeneralit Filipoviç shqiptarët u kthyen nëpër shtëpitë e tyre,³¹ konsulli britanik Kirby Green raporton se deri në tetor 1878 shqiptarët vazhdonin të dërgojnë përforsime me shqiptarë të fesë islame në Bosnje dhe Jeni Pazar për t’ju kundërvënë austriakëve nëse ata i afroreshin kufijve shqiptarë.³²

Me rënien e Bosnjës vëmendja e Lidhjes u përqëndrua në mbrojtjen e Plavës dhe Gucisë. Sulltani që në këtë kohë ishte nën presionin e Fuqive të Krishtera, dërgoi në Shqipëri Mehmet Ali Pashën një nga komandantët e luftës ruso – turke që pati përfaqësuar perandorinë në Kongresin e Berlinit. Sipas Noel Malkolmit, Mehmet Ali Pasha ishte një gjerman i konvertuar në Islam i quajtur Karl Detroit.³³ Sulltani e nisi atë që të bindë shqiptarët të lëshojnë tokat që kërkonte Kongresi i Berlinit. Ky njihte shumë krerë shqiptarë si Abdullah Pashë Drenin, Hasan Pashë Tetovën, Ali Pashë Gucinë, Shaban Be Pejën etj me të cilët pati bashkëpunuar në luftëra kundër Ruisë dhe Serbisë. Por pas takimit me këshillin e Lidhjes në Prizren ku ju kërkoi të dorëzojnë Plavën dhe Gucinë, shqiptarët jo vetëm që e kundërshtuan por në 27 gusht i vranë edhe telegrafistin grek, Sokrat Argiriadi që kishte me vete. Pasi nuk arriti të bindë parinë e Prizrenit për të zbatuar vendimet e Kongresit, Mehmet Ali Pasha shkoi në Gjakovë. Por edhe këtu paria muslimane e priti keq dhe me dyshim, ndërsa Hasan agë Batusha e ironizonte duke ju thënë katolikëve që: *‘ju të krishterët duhet të gëzoheni pse po ju vjen një kaurr si ju’*.

Muslimanët e Lidhjes së Prizrenit që nuk mund të pranonin lëshimin e tokave të tyre ndaj të krishterëve, nuk kuptonin dot sesi Mehmet Ali Pasha ju kërkonte atyre një gjë që shkon kundër Sheriatit. Krerët e Lidhjes, Mehmet Ali Pashën e quanin Maxhari (Hungarezi) pasi ky kishte qenë i krishterë më parë dhe nuk besonin që ishte bërë musliman përnjëmend si ata. Duke hapur fjalë në popull që Mehmet Ali Pasha ishte kaurr dhe për më tepër duke parë që atë e mbronte një divizion prej 80 katolikësh mirditorë, gjakovarët menduan se kanë të bëjnë më një të pafe të kamufluar, me një murted (tradhëtar) të islamit dhe agjent të ‘7 krajlive’. Për ta diskredituar si të krishterë kosovarët i bënë edhe disa poezi:

More pash pasha i Maxharit
Nuk i jam i mbretit, jam i kralit
Fjal i coj patër Marianit
Me i mbledhun krent e Fandit
Krent e Fandit me bajrak
Se në kresun ç’do me i ran
Morë hoxhë façezi
Pa ferman si del në ushtri
Hem imam hem plak haxhi
Besa Mria s’bahet turki
Ka lidh besën me shtat krali

³⁰ Fikret Karçiç (1999) in *The Bosniaks and the Challenges of Modernity*, El-Kalem, fq. 79

³¹ Xhaferr Belegu, fq. 43

³² Public Record Office, London, *F.O.195/1186* leter e datës 22 tetor 1878 nga Shkodra

³³ Noel Malcolm, fq. 222

Shtat Krali ka zan në dorë
Çon asqerin nëpër borë
Në për borë e në për shi
Nuk bahet Mria turki³⁴

Apo kjo tjetra:

Të shtatë krajlat kuvendojnë
Prizreni shka po thonë
Ni murtat n'e çoj dovleti
Shkoj n'Xhakovë te Abdulla begi
Për dy djem ç'i kish nga t'veti
Çilloj pasha kryçali
Kish pa gisht me shtat krali
Lyp hudutin çik n'Malsi
Çitni futat shpi për shpi
Shpi për shpi, mahall n'mahallë
Bini djem bajraktarë
Hanm i Pashës del në shkallë
Kuku Zot për pashallarë
Sh'na u kanë kall sarajet në flakë
Plot oborret mush me xhak
Hanm i pashës sa mir po flet
Njanin tel t'j a rrehim babës Dovlet
Ali Pashën babë ç'ta ka xhet
Sot dy javë t'u ka ba synet
Kshtu Shqipnia kish pas adet
Ka ni pashë m'e myt për vjet³⁵

Siç edhe poezitë më lartë tregojnë, muslimanët kosovarë e shihnin Mehmet Ali Pashën si një tradhëtar të islamit kur i thonë: 'More pash pasha i Maxharrit' dhe ai i përgjigjet 'Nuk i jam i mbretit, jam i kralit / Fjal i coj patër Marianit / Me i mbledhun krent e Fandit.' Edhe në poezinë e dytë po ashtu lexohet tradhëtia e Pashës dhe puna e tij për të krishterët kur poeti thotë: 'Të shtatë krajlat kuvendojnë / Prizreni shka po thonë / Ni murtat n'e çoj dovleti.' Për më tepër për të shprehur bindjen e tyre që Mehmet Aliu nuk mund të bëhej dot muslimanë thonë: 'Hem imam hem plak haxhi / Besa Mria s'bahet turki', apo edhe më tej: 'Në për borë e në për shi/ Nuk bahet Mria turki' apo edhe në poezinë e dytë kur thonë: 'Çilloj pasha kryçali'. Ndërsa imagjinata e kosovarëve që Mehmet Ali Pashën e sheh të pabesë që punon për mbretëritë e krishtera, lexohet në këto vargje: 'Ka lidh besën me shtat krali / Shtat Krali ka zan në dorë / Çon asqerin nëpër borë' apo në poezinë e dytë: 'Kish pa gisht me shtat krali'

Faktin që shqiptarët e shihnin Mehmet Ali Pashën si tradhëtar, pasi ai kishte nënshkruar Traktatin e Berlinit që ju dha tokat e tyre Serbisë dhe Malit të Zi, e përmend edhe A. H. Layard. Ky inat dhe mosbesim ndaj 'pashës kryçali' shtyu muslimanët

³⁴ Xhaferr Belegu, fq. 44 - 58

³⁵ Ibid

gjakovarë që në 6 shtator 1878 të vrasin Mehmet Ali Pashë Maxharin në kullën e Abdullah Pashë Drenit ku ishte strehuar sëbashku me ushtarët e tij mirditorë. Kont Andrasy në korespondencën e tij me Kontin Deym kujton që njerëzit kryesorë që nxitën në vrasjen e Mehmet Ali Pashës Maxharit ishin krerët e Lidhjes së Prizrenit. Ahmet Efendiu, Iljaz Pashë Korenica, Hasan Pashë Tetova, Dervish Beu nga Luma, Nazif Pasha i Prishtinës, dhe mbi të gjitha mytesarifi turk i Prizrenit, Qamil Beu.³⁶

Edhe pse pas vrasjes së Mehmet Ali Pashës mardhëniet e sulltanit u pezmatuan me krerët e Lidhes, Lidhja vazhdoi luftën e saj për të mbrojtur tokat e shqiptarëve dhe boshnjakëve. Aktiviteti i saj u pa në mbrojtjen e Plavës dhe të Gucisë, Hotin dhe Grudën dhe më në fund Ulqin, kur sulltan Hamiti i kërcënuar nga britanikët me pushtimin e Izmirit,³⁷ dërgoi Dervish Pashën për të detyruar shqiptarët që të tërhiqen nga rezistenca. Është interesant që sulltan Abdylhamiti pas fitores shpërbleu komandantin e Plavës, Ali Pashë Gucinë me titullin Pashë dhe Agabashin (një çiflig) pranë Shkupit.³⁸ Ndërsa ministri i Jashtëm Rus, Jonini deklaronte me të drejtë pas fitores së shqiptarëve në Plavë dhe Guci, se trupat e Lidhjes u mbajtën me para për 7 – 8 muaj nga Turqia.³⁹ Në anën tjetër sulltani e bëri Ali Pashën sanxhakbej të Pejës. Ali Pashë Gucija ishte nga bejlerët me të fuqishëm të Plavës. Ai ishte kajmekam i Gucisë që prej vitit 1845 dhe konsiderohej si ‘shpirti i Lidhjes.’ Gjatë kohës së Lidhjes ai shkoi jo më pak se tetë herë në Stamboll dhe bisedoi me sulltanin. Edhe gjatë caktimit të kufive nga viti 1882 – 1887 u përpoq në maksimum të ruaj madhësinë e kazasë së Gucisë, pasi këtu prekeshin edhe interesat e tij, pasi ishte çifligari më i madh i vendit dhe tokat i punoheshin nga *reajatë* e krishterë.⁴⁰

Edhe pse pas luftës së Ulqinit, Porta e Lartë e shtypi Lidhjen dhe e shpërmdau atë nën presionin e fuqive të mëdha dhe nga frika që ajo pati kur, siç Eqrem bej Vlora thotë, lëvizja u morr në dorë nga elementë ekstremistë që kërkonin me çdo kusht të realizonin programin kombëtar,⁴¹ sërisht motivimi i luftëtarëve të saj duket që ishte Islami dhe besnikëria ndaj perandorisë. Që Lidhja ishte një organizatë islamike këtë e pranon edhe Peter Bartl i cili thotë që ajo ishte një lëvizje muslimane, e kufizuar te muslimanët shqiptarë dhe që u shpall si e tillë me Karar-namenë. Për më tepër Komiteti i Lidhjes në Prizren dhe në Dibër kërkoi shfuqizimin e sistemit gjyqësor francez dhe implementimin e sheriatit.⁴²

Edhe pse brenda Lidhjes, pas themelimit të saj infiltruan bejlerë bektashi jugorë si Abdyl Frashëri,⁴³ i cili u mundua të largojë fokusin e Lidhjes nga një organizatë pan-islamike në një organizatë me nuanca gjithëpërfshirëse apo edhe grekofile, siç shihet më lartë ideali i themeluesëve të saj ishte Islami. Noel Malkolm kujton në ‘*Kosovo a short history*’ se në Shqipërinë Osmane të viteve 1880 kishte disa projekte politike. Ai përmend projektin e katolikëve mirditorë me Prenk Bib Dodën dhe Princ Nikollën e Malit të Zi që deshën të krijojnë një shtet katolik – aleat të Malit të Zi. Kemi komitetin italo – shqiptar të arbëreshëve që donin të krijojnë një shtet shqiptar sipas modelit italian. Dhe projektin

³⁶ The British Museum, London, *Accounts and Papers (38). 1878-9, LXXIX, 79, 219 – 220*

³⁷ Peter Bartl, fq. 151

³⁸ Xhaferr Belegu, fq. 80

³⁹ Ibid, fq. 87

⁴⁰ Peter Bartl, fq. 149 (citim)

⁴¹ Eqrem Bej Vlora, fq. 165

⁴² Peter Bartl, fq. 158

⁴³ mbi rolin e Abdyl Frashërit në nxitjen e kryengritjes kundër osmanëve shiko ‘*Telegram i Dervish Pashës për gjyqin e Abdyl Frashëri*’ në A. K. Fondi L. P, fot. Nr. 62

bektashian të grupit të Frashërit i cili në 1877 krijoi ‘Komitetin Shqiptar’ të Janinës që synonte të ndërtojë një shtet shqiptar duke bashkëpunuar me Greqinë fillimisht.⁴⁴ Siç edhe transkripti i procesit hetimor të Mehmet Nazifit dhe Abdylgani Frashërit tregon, zyrtarët osmanë dyshonin që Frashërllitë ishin implikuar në Lidhjen e Prizrenit për të ngritur Gegërinë në luftë kundër osmanëve dhe bashkimin e Toskërisë me Greqinë. Në aktpadinë e gjyqit ushtarak grupi i Frashërit akuzohej për nxitjen e rebelimit në Toskëri në bashkëpunim me kryetarin e komitëve (kleftëve) grekë Arvanido Arsidin dhe bashkimin e Toskërisë me Greqinë.⁴⁵ Ndërsa në anën tjetër konsulli Kirby Green në letrën që ja çon kontit Granville më 22 qershor 1880 i sqaron që Lidhja si organizatë nuk duhej mitizuar dhe konfuzuar me Komitetet Shqiptare të cilat kanë ekzistuar me kohë por nuk kanë patur ndonjë forcë, siç kishte Lidhja e cila fuqizohej sa herë që donte qeveria.⁴⁶ Rrëfimi i Kirby Green-it është demitizuesi më i mirë i teorive që historianët e ndikuar nga nacionalizmi romantik i Rilindjes kanë imagjinuar për Lidhjen që e shtrijnë nga Stambolli e deri në Itali dhe i mveshin idealet e rilindjes dhe iluminizmit. Apo shpesh i atribuojnë deklarata që nuk kanë të bëjnë me atë, siç është për shembull deklarata anti – turke e katolikëve të Shkodrës dhe Triestes e datës 13 qershor 1878⁴⁷ apo edhe vendimet, që për mua janë sajuar nga Kristo Dako, në librin ‘Liga e Prizrenit’ në Bukuresht më 1922.⁴⁸

Megjithë infiltrimin e bektashive jugorë në Lidhjen e Prizrenit, të cilët ishin përçues të ideve të Rilindjes dhe antagonistë me osmanët,⁴⁹ karakteri i përgjithshëm i Lidhjes u dominua nga sunitët dhe qeveria osmane të cilët, siç u lexua edhe më lartë luftën e bënin në emër të Islamit dhe Sheriatit, kundër ‘kryçalive’ serbo – malazezë. Ndërsa në Toskëri ne shohim komitetet e bektashive që gjejnë gjuhë të përbashkët me vllahët dhe ortodoksët apo edhe Greqinë, në Gegëri lufta e Lidhjes ishte ndërmjet *miletit islam* dhe ndonjëherë katolikëve që nuk kishin ndonjë peshë, dhe *shkijave*. Në betejën e Plavës dhe Gucisë, muslimanët gegë u përballën me ortodoksët shqiptarë, Mark Milanin dhe Theodhor Milanin që luftonin për Malin e Zi.⁵⁰ Ndërsa shqiptarët dhe boshnjakët e shikonin veten e tyre si një komb apo si *milet islam*, por duke përfshirë edhe katolikët ndonjëherë, siç tregoi edhe lufta e përbashkët në mbrojtjen e Hotit dhe Grudës. Kombi i imagjinuar i gegëve synitë duket që ka qënë i ndërtuar mbi bazat e *dinit* dhe *imanit*, *devletit* dhe sulltanit dhe jo anti-turqizmit siç e imagjinonin bektashianët e jugut apo ortodoksët e diasporës kombësinë. Për të kuptuar më qartë se çfarë kërkonin muslimanët e Gegënisë dhe si e imagjinonin veten, ndoshta duhet të lexojmë rrëfimin e Kirby Greenit, i cili pasi ishte takuar me disa krerë të Lidhjes në nëntor 1878, rrëfen që:

Lëvizja shqiptare duhet parë si një përpjekje e kombit osman i cili e sheh veten të rrethuar nga rreziqet pothuaj të pakapërcyeshme dhe se shpresa e vetme që kishin ishte që anglezët ti mësojnë dhe udhëheqin në zgjidhjen e kësaj çështje. Ata vetë u ngushëlluan me detyrimin fetar që kishin për të ndarë fatin e tyre me Halifin

⁴⁴ Noel Malcolm, fq. 218 – 221

⁴⁵ për më shumë shiko A.K. Fondi, L.P. fot. Nr. 68 mbi ‘procesin hetimor të Mehmet Nazifit dhe Abdylgani Frashërit’

⁴⁶ *Letër e Kirby Green Kontit Granville*, The British Museum, London, *Accounts and Papers* (43). 1880, LXXXII, 82, 511 – 512

⁴⁷ Shikoji në: Xhaferr Belegu, fq. 22 – 23

⁴⁸ Shikoji në ibid, fq. 35 – 38

⁴⁹ për rolin e shehlerëve bektashian kundër pushtetit osman dhe nxitjen e Toskërisë në luftë shiko:

Telegram i Dervish Pashës për Shehlerët Bektashianë, A. K. Fondi L. P, fot. Nr. 63. Datë 12. 5. 1881

⁵⁰ Xhaferr Belegu, fq. 76

(mëkëmbësin e profetit Muhamed – sulltanin) dhe pastaj paralajmëruan se nën udhëheqjen angleze çdo gjë do të përfundoj mirë.⁵¹

Pra nëse duam të kuptojmë identitetin dhe karakterin e organizatorë të Lidhjes së Prizrenit sipas konsullit Kirby Green dhe jo Kristo Frashërit, i bie që Lëvizja shqiptare duhet parë si një përpjekje e *miletit islamik* apo e *kombit osman* i cili e shikonte fatin e tij të njëjtë me atë të muslimanëve të tjerë të Perandorisë dhe sulltanit Halif, dhe jo sipas skemave ‘politikisht korrekt’ që ideologjia nacional-komuniste e Akademisë së Shkencave mundohet të ndërtojë mbi identitetin e pashallarëve, bejlerëve dhe ulemave islamikë të Gegënisë që formuan Lidhjen e Prizrenit në fundshekullin e XIX.

REFERENCA:

Dokumenta burimorë

Peticion nga paria muslimane e Shkupit, mars 1878, The British Museum, London, *Accounts and Papers* (38). 1878, 83, 933

Peticion nga banorët e Dibrës 16 maj 1878, Public Record Office, London, F.O.195/1206

Peticion i banorëve të Prizrenit i dërguan ambasadave të Anglisë, Francës, Italisë dhe Austro-Hungarisë 12 maj 1878, The British Museum, London, *Accounts and Papers* (38). 1878, LXXXIII, 83, 931, 932

Leter nga konsulli britanik Kirby Green 3 maj 1878, Public Record Office, London, F.O.195/1186

Karakterit i Lidhjes nga Kirby Green, Shkodër më 11 nëntor 1878, The British Museum, London, *Accounts and Papers* (38). 1878 – 9, LXXIX, 79, 538 – 539

Letër e M. Delyanit datë 9/21 shkurt 1879, The British Museum, London, *Accounts and Papers* (36). 1878-9, LXXVII, 77, 336 – 337

Letër e Kirby Green Kontit Granville, The British Museum, London, *Accounts and Papers* (43). 1880, LXXXII, 82, 511 – 512

Leter e datës 22 tetor 1878 nga Konsulli Kirby Green, Shkodër, Public Record Office, London, F.O.195/1186

⁵¹ Shkodër më 11 nëntor 1878, The British Museum, London, *Accounts and Papers* (38). 1878 – 9, LXXIX, 79, 538 – 539

Kont Andrasy për Kontin Deym, Tetor 1878, The British Museum, London, *Accounts and Papers* (38). 1878-9, LXXIX, 79, 219 – 220

'*Telegram i Dervish Pashës për gjyqin e Abdyl Frashëri*' në A. K. Fondi L. P, fot. Nr. 62

Proçesi hetimor i Mehmet Nazifit dhe Abdylgani Frashërit, A.K. Fondi, L.P. fot. Nr. 68

Telegram i Dervish Pashës për Shehlerët Bektashianë, A. K. Fondi L. P, fot. Nr. 63. Datë 12. 5. 1881

Mbledhur nga Skender Rizaj (1978) *Lidhja e Shqiptare e Prizrenit ne Dokumentet Angleze (1878 – 1881)*, Prishtinë

Mbledhur nga Ilijaz Rexha (1978), *Lidhja e Prizrenit në Dokumente Osmane (1878 – 1881)*, Prishtinë

Libra & Artikuj

Evangelos Kofos (1982), *Greek reaction to the Albanian League of Prizren*, Balkan Studies, Vol 23

Jacob Landau (1990), *Politics of Pan-Islam*, Oxford University Press

Noel Malcolm (1999), *Kosovo a short history*, Harper Collins

Historia e Popullit Shqiptar (2002), Vol II, Rilindja Kombetare vitet 30 te shek. XIX – 1912, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Toena, Tiranë

Peter Bartl (2006), *Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912)*, Tiranë

Xhafer Belegu (1939), *Lidhja e Prizrenit e veprimet e sajë, 1878 – 1881*, Tiranë

Eqrem bej Vlora (2001b), *Kujtime – Vëllimi i parë 1885-1912*, Tiranë

Fikret Karçiç (1999) *The Bosniaks and the Challenges of Modernity*, El-Kalem

Stavro Skëndi (2000b), *Zgjimi Kombëtar Shqiptar*, Phoenix & Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit

مغایرت

برخی - اگر کسی از معجزات در تفسیر این معجزات از آنکه در کتب آمده و در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب
توضیح هر یک از اینها آورده نفس بر این است که در کتب آمده و در بعضی کتب و در بعضی کتب
سفر از تفسیر کتب - و در آن کتب که در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب
در آن کتب که در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب
کوفه - تفسیر این کتب که در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب

اگر کسی از تفسیر این کتب که در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب
بر طرف دیگر است که در کتب آمده و در بعضی کتب و در بعضی کتب
نسخ و کتب که در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب
مشکل نوشته در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب
حکایتی که در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب
در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب

اگر کسی از تفسیر این کتب که در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب
تفسیر این کتب که در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب
اگر کسی از تفسیر این کتب که در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب
تفسیر این کتب که در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب
اگر کسی از تفسیر این کتب که در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب
تفسیر این کتب که در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب

اگر کسی از تفسیر این کتب که در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب
تفسیر این کتب که در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب
اگر کسی از تفسیر این کتب که در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب
تفسیر این کتب که در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب
اگر کسی از تفسیر این کتب که در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب
تفسیر این کتب که در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب

اگر کسی از تفسیر این کتب که در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب
تفسیر این کتب که در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب
اگر کسی از تفسیر این کتب که در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب
تفسیر این کتب که در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب
اگر کسی از تفسیر این کتب که در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب
تفسیر این کتب که در بعضی کتب و در بعضی کتب و در بعضی کتب